

Hanifen po atë ditë në varrezat e fshatit. Pas luftime, më 2.09.1999, mbetjet mortore të Hanifes u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Aqarevë/Ovçarevo.

Burimet: deklarata M.J, FDH-18201; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

Driton (Nasuf) Hysenaj

(3.06.1981, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Glllogocit/Glogovac, nxënës)

Dritoni jetonte në Obri të Epërme/Gornje Obrinje, në *Mëhallën Hysenaj*. Kur, më 25.09.1998, filluan përlëshjet e armatosura në mes të forcave të UÇK-së dhe atyre serbe në fshat, Dritoni me familje dhe banorë të fshatit u strehuan në pyll mbi fshatin Tërdec/Trdevac. Në mesin e refugjatëve më së shumti kishte gra, fëmijë dhe pleq. Por, në mesin e tyre ishin edhe afro njëzet burra dhe djelmoha. Dy ditë më vonë, më 27.09.1998, forcat serbe i zbuluan refugjatët në pyll. E kanë ndarë Dritonin dhe burra të tjerë. I zhveshën dhe i bastisën. Pastaj, ua lidhën duart dhe i detyruan që të shtriheshin në kanal. Pas gjysmë ore, i çuan në *Mëhallën Hysenaj*, i hipën në rimorkion e traktorit dhe u nisën në drejtim të Likocit/Likovac. Në të dy anët e rrugës gjendeshin pjesëtarë të forcave serbe. I afroreshin traktorit, i shanin, u qeponin dhe i ofendonin Dritonin dhe burrat. Në hyrje të **Likocit/Likovac**, te pylli, rimorkiosiu afrua një pjesëtar i forcave serbe në uniformë maskuese dhe me një thikë të gjatë. E kapi Dritonin për flokët dhe e theri në fytyrë. Pastaj, burrat u transferuan nga rimorkioja e traktorit në një kamion ushtarak dhe u bartën në Glllogoc/Glogovac, përderisa trupit i Dritonit ka mbetur në rimorkio. Trupit i tij është gjetur më 13.11.1998 në Likoc/Likovac, në një varr që nuk ishte gropuar në thellësi të madhe. Po atë ditë, familjarët i kanë marrë mbetjet mortore të Dritonit dhe i kanë varrosur në varrezat e Obrisë së Epërme/Gornje Obrinje.

Burimet: deklarata B.H, FDH-8890; deklarata B.H, FDH-16526; deklarata K.H, FDH-16527; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998,

146, FDH-23857; *Një nga policët u afrua me thikë në dorë dhe e preu në fytyrë Dritonin*, Koha Ditore, 14.11.1998, FDH-18406; *Albanian Youth, Killed Almost Two Months Ago, Buried in Obri Village*, pasqyra e lajmeve, KIC, 14.11.1998, FDH-30649.

Xhavit (Isuf) Uka

(2.01.1949, shqiptar nga Aqareva/Ovçarevo, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, nëntë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Xhaviti me bashkëshorten Razën jetonin në bashkësi familjare me fëmijët dhe nipërit e tyre. Në datën 27.09.1998, Xhaviti mori vendim ta çonte familjen në një strehimore, të cilën e kishte përgatitur më parë në periferi të fshatit. Sapo kanë hyrë në strehimore, një ushtar serb erdhi përpara saj dhe u urdhëroi që të gjithëve të dilnin jashtë. Pranë tij qëlluan të ishin edhe disa ushtarë të tjerë serb. E kanë ndarë menjëherë Xhavitin dhe filluan t'i mëshonin me kondakët. Razës dhe fëmijëve u urdhëruan që të largoheshin. Ata u nisën, por sapo u larguan disa metra më larg, i dëgjuan të shtënat dhe panë se pjesëtarët e forcave serbe e kanë vrarë Xhavitin [**Aqarevë/Ovçarevo**]. Në mbrëmje, disa ushtarë të UÇK-së e kanë mbuluar trupin e Xhavitit me gjethe, ndërkajsh familjarët e kanë varrosur ditën tjetër në pyll. Gati dy muaj më vonë, më 22.10.1998, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Xhavitit në varrezat e fshatit. Pas luftime, në muajin shtator të vitit 1999, mbetjet mortore të Xhavitit përfundimisht u varrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Aqarevë/Ovçarevo.

Burimet: deklarata R.U, FDH-32458; J. Martinzen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Shpëtim (Zeqir) Robaj

(15.10.1957, shqiptar nga Prishtina/Priştina, mjek, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Shpëtimi ka qenë mjek anesteziolog në spitalin e Prishtinës/Priştina dhe asistent në Fakultetin e Mjekësisë. Nën përkujdesjen e organizatës humanitare *Nënë Tereza/Majka Tereza*, së bashku me mjekë të tjerë shqiptar, punonte nëpër ambulancat gjithandej Kosovës. Në pranverë, verë dhe vjeshtë të vitit